

2. Lidhni me shigjetë duke përdorur tabelën dhe duke formuar disa fjali që lidhen me veprimtarët në fushën e teknologjisë.

Profesioni	Cilësia	Arsyet
1.Programues	__Pajisje të sofistikuara informative	__sepse janë zhvillimet më të mëdha dhe më të dobishme për njerëzimin në këtë shekull
2.Informaticien	__.njerëz shumë inteligjentë dhe krijues	__që po I shërbejnë shumë fushave të veprimtarisë njerëzore
3.Reklambërës	__. kreativ	__që bën publikime për shumë biznese dhe veprimtari arti
4.Shitës pajisjesh teknologjike	__. promovues dhe shpërndarës i pasionuar	__për shpërndarjen e pajisjeve teknologjike
5.Përdorues IT	__.nxënës/student të vullnetshëm për të nxënë	__që shohin pajisjet e tech të domosdoshme dhe jetike

3. Bashko pjesët e shprehjeve dhe formoni fjali me 4 prej tyre.

Shtri këmbet
 Nuk ka pyll
 Flet si kodra
 Ata kanë gjetur
 Bukuria e gruas
 Bukuria një dite
 Burri s'matet me pëllëmbë
 E thëna dhe e bëra
 Njeriun e bëjnë të përjetshëm
 Atë kokë pati,
 Ajo këmbë që thyhet,

veprat e tij
 në atë vend nuk zihet.
 mbas bregut.
 por me zemër
 janë shume larg.
 veprat një jetë.
 tenxherja kapakun..
 duket ne mengjes.
 sa ke jorganin.
 atë feste vuri.
 pa derra.

4. Korrigjoni gabimet:

Këta njerëz do të pastroen së shpejti nga djerësa, alkoli, ndryshku i pritjes duke u lar në ujin mbretëror të natës të luftës. Unë e ndjej se ata janë gati-gati të pastruar. Por ata përpiqen ta gëzojnë sa të mundin më gjatë baletin e të dehurit dhe të shishes. Ata do t'përpiqen t'a zgjasin sa më tepër që të mundin këtë lojë shahu. Ata e zgjasin jetën aq sa mund që ta zgjasin. Por ata kanë kurdisur një sahat me zile që mbretëron mbi një raft libra. Së shpejti zilja do të bierë. Atëhere këta njerëz

do t'vishen, do të tërheqin dhe shtrëngojnë rrypat. Kapitani do të heq atëhere revolen nga gozhda. I dehuri do të vijë atëhere në vete. Atëherë të gjithë do të përshkojnë pa u ngutur koridorin që vjen duke u ngritur butë, deri tek një katërkëndsh i kaltëryer nga hëna. Ata do të thonë ndonjë gjë të thjeshtë si "Sulm i mallkuar"... ose: "Qenka ftohtë!". Pastaj do të hidhen në sulëm.

5. Zgjeroni fjalitë e kësaj pjese me rrethana (që tregojnë rrethanën e kryerjes së një veprimi).

Qyteti nuk po e merrte veten. Turistët holandezë ishin larguar. Beni u mërzit. Nuk e kishte dashur këtë largim. Dielli u fsheh. Ra errësira. Ai shkoi në dhomën e punës. Nxori shënimet. Nuk lexonte. Sytë i dhimbnin. Shkronjat i ngatërroheshin. Shkoi në dhomën e gjumit. Truri i punonte. Nuk i flihej. U ngrit dhe doli. Nuk kishte njeri. Qetësi e plotë.

6. Krijoni folje nga fjalët që vijojnë dhe formoni fjali me 4 prej tyre.

vizë, fund, kurajë, faqe, gati, djersë, i lirë, i madh, lart, përpara, vetë, mjau, çercëri, kundër.

7. Një mik i cili jeton në një vend tjetër të ka ftuar për të bërë pushimet në vendin e tij. Ju jeni shumë i zënë për të pranuar ftesën. Shkruajini një letër mikut tuaj. Mbani parasysht:

- Falënderojeni atë për ftesën.
- Shpjegoni pse nuk mund të shkoni.
- Jepini disa lajme të reja që kanë lidhje me ju dhe punën tuaj.
- Premtojini që do të takoheni shume shpejt.
